



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 2

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e adoptimit të objektit ish-komuna Qendër Ersekë në banesa sociale.”
3. **Projekt-Vendim** “Për disa ndryshime në vendimin nr.14 datë 27.01.2026.
“Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit, për mirësimi e kushteve të banesave ekzistuese”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit”.
4. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”
5. **Projekt-Vendim** “Për miratimin paraprak të vazhdimit të procedurave për dhënien me qira pasurisë, me Nr. 4/72, z.k. 1594 Ersekë”.
6. **Projekt-Vendim** “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore “Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”

Protokolli i mbajtur sot më datë 13.02.2026 në mbledhjen e rradhës sipas njoftimit të dhënë në datën 09.02.2026.

Të pranishëm: E.Isai, E. Xhelili, I.Milo, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, S.Kodra, E.Avdi, I.Hodo, E.Çikopana, A.Zeneli.

Mungon: A.Tartari, B.Jashari, T.Çaçani, S.Larti, H.Iljazi,

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen e dates 13.02.2026 pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës?

E. Xhelili: Me pikën pesë të rendit të ditës kam konflikt interesi.

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës “Për miratimin e adoptimit të objektit ish-komuna Qendër Ersekë në banesa sociale.”

E.Isai : Në projekt vendim paraqet nevojën për adoptimin dhe rikostruksionin e objektit ish-Komuna Qendër Ersekë, në pronësi të Bashkisë Kolonjë, për përdorim për Banesa Sociale. Objekti aktualisht nuk shfrytëzohet për funksione administrative dhe përshtatet për krijimin e njërive të banimit.

Z.Meto: Sa familje do jetojnë në këtë objekt?

E.Isai: Aty do të jetojnë diku tek 6-8 familje.

E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës “Për disa ndryshime në vendimin nr.14 datë 27.01.2026 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit, për mirësimin e kushteve të banesave ekzistuese”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit”.

P.Çunge : Këto 7 familje pse janë pezulluar nga lista.

E.Dake: Listës së personave aplikues nga programi është 22 familje të depozituar tek komisioni i Strehimit. Komisioni i Strehimit është mbedhur, duke verifikuar fotot dhe dokumentacion ku është filtruar lista janë skualifikuar 7 familje për shkak të mos plotësimit dokumentacioni. Kriteret kryesore për të përfituar nga projekti “ Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese” janë: Banesa të jetë në emër të aplikuesit me certifikate pronësie ose vërtetim nga ASHK, vërtetim banimi, vërtetim ndihme ekonomike, vërtetim pensioni, fotokopje kartë identiteti, certifikate familjare, dhe aplikim në E-albania. Keta shtatë persona janë sukaifikuar për keto arsye: Kristul Vasili nga verifikimi i kryer në banesë nuk ndodhet në shtëpi, kemi kërkuar informacion dhe nga policia e Shtetit, nxjerr informacionin marrë nga sistemi Tims, zotëria ka dal nga Aeroporti i Rinasit që në vitin 2024 dhe nuk është kthyer, Mirësi Memo nuk posedon certifikatë pronësie, Guri Zahari mungesë dokumentacioni dhe pa certifikatë pronësie, Eristjano Murat përfiton nga Znj.Antoneta Murati që është e ëma sepse ka statusin invalid por nga verifikimi i kryer në banesë ndodhet jashtë shtetit dhe kjo ka që nga viti 2024 që është larguar nga Aeroporti i Rinasit dhe nuk është kthyer deri më sot, Ali Hamza mungesë dokumentacioni, Panajot Josifi mungesë dokumentacioni, Shefiqe Pasho nuk përfiton asnjë kategori.

E.Isai: Personave që nuk jetojnë në Kolonjë kush ju’a plotëson dokumentacionin?

E.Dake: Vinë aplikojnë të afermit e personave.

E.Isai: Nuk duhet të pranoni si këto raste, personat e interesuar duhet të vinë vetë për të aplikuar, projekti është për familjet në nevojë jo për familjet që janë jashtë shtetit.

P.Çunge: Mirësi Memo duhet ta kishte përfituar këtë projekt, sepse jeton e vetme pa asnjë kusht , ka humbur dhe djalin dhe bashkëshortin.

E.Dake: E kam parë zonjën dhe nga afër kemi vajtur në shtëpia por nuk posedon certifikatë pronësie dhe për mungesën e një dokumenti nuk fitohet projekti.

E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”

E.Isai: Janë fondet e papërdorura deri në fundin e vitit 2025 nga transferata e pakushtëzuar dhe e specifikuar, të ardhurat e çelura vitin 2025 dhe të ardhurat e paçelura viti 2025.

E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto:Kryetari i Këshillit është konflikt interesi me pikën numer pesë të rendit të ditës, po e prezantoj unë si zv/kryetar i këshillit bashkiak pikën pesë të rendit të ditës “Për miratimin paraprak të vazhimit të procedurave për dhënien me qira pasurisë, me Nr. 4/72, z.k. 1594 Ersekë”.

Z.Meto: E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Abstenim 1 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën gjashtë të rendit të ditës “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore “Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”


E.Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

Proces-Verbali i datë 13.02.2026 është firmosur nga 10 anëtarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT

INSUIDA ORHANAS



KRYETAR I KËSHILLIT

ERALDO XHELILI

